

VENDIM
Nr. 354, datë 25.6.2025

PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË FSHATIN TAÇ LARTË, BASHKIA KOLONJË, QARKU KORÇË, NGA SHOQËRIA “FORTIS ENERGY AND CONSTRUCTION” SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në fshatin Taç Lartë, Bashkia Kolonjë, qarku Korçë, nga shoqëria “*Fortis Energy and Construction*” sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

- a) emri i aplikuesit: Shoqëria “*Fortis Energy and Construction*” sh.p.k.;
- b) NIPT/NUIS: M11821012G;
- c) tipi i centralit: fotovoltaik;
- ç) kapaciteti i instaluar: 62 MW;
- d) afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- dh) vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: në fshatin Taç Lartë, Bashkia Kolonjë, qarku Korçë;
- e) afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- ë) koordinatat e tokës dhe planvendosja sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme, me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;
- g) Shoqëria “*Fortis Energy and Construction*” sh.p.k., ka detyrimin që:
 - i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;
 - ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;
 - iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë “*Fortis Energy and Construction*” sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penaltetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;
 - iv. t’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria “*Fortis Energy and Construction*” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKSI 1

KOORDINATAT NË KRRGJSH PËR <i>FORTIS ENERGY AND CONSTRUCTION</i> 62 MW					
Nr.	x	y	Nr.	x	y
1	559831.829	4465406.658	32	559202.203	4464340.519
2	559574.486	4464909.195	33	559253.081	4464377.144
3	559489.736	4464442.724	34	559252.736	4464415.753
4	559450.018	4463985.780	35	559198.199	4464445.936
5	559400.895	4463786.578	36	559128.034	4464497.927
6	559359.699	4463771.109	37	559056.036	4464553.687
7	559335.681	4463724.290	38	559017.011	4464569.688
8	559303.415	4463699.461	39	559080.026	4464639.079
9	559264.602	4463673.682	40	559109.603	4464647.657
10	559229.365	4463625.159	41	559142.588	4464685.724
11	559201.257	4463614.272	42	559184.567	4464739.045
12	559210.130	4463583.085	43	559268.961	4464780.246
13	559147.734	4463582.511	44	559233.282	4464862.118
14	559118.947	4463583.246	45	559200.940	4464902.994
15	559098.327	4463576.541	46	559122.638	4464981.327
16	558952.531	4463657.488	47	559091.586	4464994.996
17	558922.558	4463686.026	48	559225.885	4465350.528
18	558878.752	4463789.353	49	559203.428	4465409.179
19	558853.542	4463896.302	50	559150.297	4465467.619
20	558869.280	4463964.575	51	559195.081	4465521.972
21	558908.937	4464009.389	52	559175.531	4465561.213
22	558925.741	4464092.085	53	559113.689	4465525.265
23	558974.308	4464233.912	54	559062.031	4465609.439
24	558965.723	4464396.701	55	559076.325	4465616.876
25	559008.400	4464369.276	56	559205.683	4465553.177
26	559007.768	4464334.807	57	559267.760	4465488.218
27	559024.025	4464325.786	58	559323.179	4465471.961
28	559039.881	4464328.118	59	559378.429	4465494.290
29	559088.670	4464298.454	60	559508.947	4465485.866
30	559125.506	4464336.711	61	559603.727	4465439.978
31	559177.211	4464311.851			

